

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7849
E mërkurë, 31 korrik 2024
Çmimi 0.50 €

Klinika e Radiologjisë pranon një CT, donacion nga ShBA-ja

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

POZITA E KOMISIONARIT TË ZGJERIMIT TË BE-së BËHET SËRISH TËRHEQËSE

FAQE 4



Menjëherë pasi Parlamenti Evropian, më 18 korrik, ka konfirmuar Ursula von der Leyenin në pozitën e

presidentes së Komisionit Evropian edhe për një mandat të ri pesëvjeçar, kanë filluar kalkulimet se kush do

t'i ketë pozitat kryesore në kolegjin e ri të komisionarëve, siç njihet Komisioni Evropian

DEMOKRACI PLUS: KOMUNA E PRISHTINËS SHKELI LIGJIN E PROKURIMIT PUBLIK NË KONTRATËN 12-MILIONËSHE PËR SHËRBIMIN 'ARKITEKTI I QYTETIT'

F. 5



FILLOJNË AKTIVITETET "FALEMINDERIT MËRGATË"

F. 3



AKTUALE



BIDENI KRITIKON "EKSTREMIZMIN" NË GJYKATËN SUPREME, BËN THIRRJE PËR MANDATE ME LIMITE

F. 2

APELI I GJYKATËS SPECIALE DO TA SHOYRTOJË SËRISH ULJEN E DËNIMIT NDAJ MUSTAFËS

F. 3

ZJARRE PRANË ZONËS TURISTIKE NË SHËNGJIN, EVAKUOHEN BANORËT

F. 3

EKONOMI



DJEGIA E HAMULLOREVE, MINISTRIA E BUJQËSISË: PARAQET KËRCËNIM

F. 8

DËRGOHEN NË KUVEND EMRAT E DY KANDIDATËVE PËR EMËRIM NË BORD TË TRUSTIT

F. 8

SPORT



SA KUSHTOJNË MEDALJET E ARTA?

F. 10

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVE
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Bideni kritikon “ekstremizmin” në Gjykatën Supreme, bën thirrje për mandate me limite

WASHINGTON, 30 KORRIK - Presidenti amerikan Joe Biden ka thënë se “ekstremizmi” në Gjykatën Supreme të Shteteve të Bashkuara është duke minuar besimin publik në këtë institucion dhe i ka bërë thirrje Kongresit të përcaktojë afate kohore në mandate dhe të fuqizojë një kod etike për nëntë gjyqtarët e kësaj gjykate. Ai, po ashtu, u ka bërë thirrje ligjvënësve të ratifikojnë një ndryshim kushtetues që kufizon imunitetin presidencial. Bideni, të cilit i kanë mbetur më pak se gjashtë muaj në Shtëpinë e Bardhë, i ka bërë këto deklaratë në një librari presidenciale në Austin të Teksasit, për ta shënuar 60-vjetorin e Aktit për Liri Civile. Thirrjet e tij për ndryshime dramatike në gjykatë kanë pak mundësi të miratohen nga Kongresi thellësisht i ndarë, vetëm 99 ditë para ditës së zgjedhjeve presidenciale. Megjithatë, demokratët besojnë se këto kërkesa do t'i bëjnë votuesit që të fokusohen në prioritetet. Nënpresidentja amerikane Kamala Harris, e cila ka mundësi të jetë e nominuara e demokratëve për garën presidenciale, po përpiqet ta portretizojë veten në garën kundër republikanit Donald Trump si “zgjedhje në mes të lirisë dhe kaosit”. Ajo gëzon edhe përkrahjen e Bidenit në garën për presidente të ShBA-së. “Ekstremizmi është duke minuar besimin publik në vendimet e gjykatës”, ka thënë Bideni. “Ne mundemi, dhe ne

duhet ta parandalojmë abuzimin e fuqisë presidenciale, dhe ta rikthejmë besimin në Gjykatën Supreme”. Shtëpia e Bardhë është përfshirë në zemërimin në rritje të demokratëve për Gjykatën Supreme, e cila ka shumicë të konservatorëve, gjashtë të tillë - dhe ka lëshuar opinione që kanë përmbysur vendime historike, sikurse ai për të drejtat e abortit. Harris ka thënë përmes një deklaratë se reformat e propozuara janë të nevojshme, sepse “ekziston një krizë e qartë në besimin që lidhet me Gjykatën Supreme”. Udhëheqësi i Dhomës së Përfaqësuesve, republikani Mike Johnson, e ka quajtur propozimin të “rrezikshëm” dhe që dokumenti do të ishte i vdekur sapo të dërgohej në institucionin që drejton ai. Trumpi i ka hedhur poshtë propozimet dhe i ka konsideruar “mashtrime tipike të Bidenit”. “Nuk do të shkojnë askund. Edhe ai vetë e di këtë”, ka thënë Trumpi në një intervistë për “Fox News”. Bideni kërkon të mos ketë emërime të përhjetshme për gjyqtarët në Gjykatën Supreme. Ai beson se Kongresi duhet të krijojë një legjislacion për të miratuar një sistem që presidenti amerikan do të emëronte një gjyqtar çdo dy vjet, me mundësi të shërbimit për 18 vjet në gjykatë. Sipas tij, mandatet me afate do të garantonin ndryshim në përbërjen e gjykatës dhe do të “zvogëloheshin mundësitë që një president të ketë ndikim në



gjeneratat e ardhshme”. Ai ka kërkuar që Kongresi të miratojë edhe një kod etike për gjyqtarët, që ata t'i bëjnë publike dhuratat, të përmbahen prej aktivitetit politik publik dhe të përjashtohen prej rasteve, në të cilat ata apo bashkëshortët e tyre kanë konflikte interesi apo konflikte të tjera. Bideni i ka bërë thirrje Kongresit që të miratojë edhe ndryshime kushtetuese për të rrëzuar një vendim të Gjykatës Supreme, i

cili parasheh se ish-presidentët amerikanë kanë imunitet nga përndjekja ligjore. “Ky komb është krijuar mbi parimin se nuk ka mbretër në Amerikë”, ka thënë Bideni. “Të gjithë ne jemi të barabartë para ligjit. Askush nuk është mbi ligjin. Në praktikë, vendimi i gjykatës pothuajse qartë nënkupton që presidenti mund ta shkelë betimin dhe të mos përballet me pasojat”. Shumica e amerikanëve përkrahin një mënyrë për ta

kufizuar mandatin e gjyqtarëve të Gjykatës Supreme, sipas një sondazhi të kryer në gusht të vitit 2023 nga AP-NORC. Dy të tretat e respondentëve kanë thënë se gjyqtarëve të Gjykatës Supreme duhet t'u kërkohej të pensionohen në një moshë të caktuar. Demokratët janë më të prirë ta kërkojnë pensionimin e gjyqtarëve, 77 për qind, në krahasim me republikanët, 61 për qind.

Turqia miraton ligj për largim të qenve endacakë nga rrugët, opozita e kundërshton



ANKARA, 30 KORRIK - Ligjvënësit në Turqi kanë miratuar të martën një ligj të ri për largim të miliona të qenve endacakë nga rrugët e vendit, por mbrojtësit e kafshëve frikësohen që kjo masë do të rezultojë me vrasje të shumë qenve apo neglizhim të tyre në strehimore të mbingarkuara. Disa besojnë që ligji mund të përdoret për ta shënjestruar opozitën, e cila ka shënuar fitore të mëdha në zgjedhjet lokale të mbajtura muaj më parë. Deputetët e Asamblesë së Madhe Kombëtare të Turqisë e kanë miratuar legjislacionin pas një seance maratonë, meqë qeveria ka kërkuar që legjislacioni të miratohet para pushimit veror të parlamentit. Ndërkohë nëpër qytetet turke janë mbledhur mijëra protestues, të cilët kanë bërë

thirrje për mosmiratim të ligjit, i cili mundëson që për disa kafshë endacake të përdoret eutanazia - vdekje e asistuar. Ligjvënësit opozitarë dhe grupet për mbrojtje të kafshëve e kanë quajtur dokumentin si “ligj për masakër”. Presidenti turk Recep Tayyip Erdogan ka thënë se ligji i ri është i domosdoshëm për t'u përballur me “problemin e qenve endacakë” në nivel vendi. Qeveria vlerëson se rreth 4 milionë qen endacakë lëvizin nëpër rrugët e Turqisë dhe në zonat rurale. Ndonëse shumica prej tyre janë të parrezikshëm, ka raste kur ata kanë lëvizur në tufa dhe kanë sulmuar njerëzit. Në projektligj nuk janë përfshirë macet, të cilat janë gjithandej nëpër rrugët e Turqisë.

Apeli i Gjykatës Speciale do ta shqyrtojë sërish uljen e dënimit ndaj Mustafës

Prishtinë, 30 korrik - Paneli i Gjykatës Supreme, që funksionon në kuadër të Gjykatës Speciale në Hagë, ia ka rikthyer sërish Apelit rastin e Salih Mustafës dhe dënimit ndaj tij për krime lufte.

Mustafa, ish-komandant i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, është dënuar fillimisht në dhjetor të vitit 2022 me 26 vjet burgim për vrasje të paligjshme, ndalim arbitrar dhe torturë. Në dhjetor të vitit 2023, Apeli ia pati ulur dënimit në 22 vjet burgim. Gjykata Speciale heton krimet e pretenduara të anëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës kundër pakicave etnike dhe rivalëve politikë në periudhën janar 1998 - dhjetor 2000.

Gjykata e ka selinë në Hagë të Holandës, por funksionon sipas ligjeve të Kosovës.

Përmes një komunikate për media më 30 korrik, Gjykata Speciale ka thënë se, pas kërkesës së bërë nga Mustafa për mbrojtje të ligjshmërisë, paneli i Supremes e ka rikthyer rastin e tij tek Apeli për ta shqyrtuar uljen e dënimit.

Mbrojtja e ligjshmërisë është mjet juridik përmes të cilit synohet të korrigohet ndonjë gabim potencial në procedurë gjyqësore. "Paneli është i mendimit që paneli i Apelit duhet të ketë mundësi për të vlerësuar nëse dënimi prej 22 vjetësh burgim për Mustafën është ende i arsyeshëm, pas jurisprudencës së analizuar", është thënë në vendimin e Supremes.

Mustafa ka qenë personi i parë që është dënuar prej Gjykatës Speciale lidhur me akuzat për krime lufte.

Në korrik të këtij viti, Gjykata ka dënuar edhe Pjetër Shalën me 18 vjet burgim për krime lufte. Sipas Gjykatës, viktimat kanë qenë kryesisht shqiptarë të Kosovës, të cilat kanë pësuar dëme nga shqiptarë të tjerë të Kosovës.

Përveç Mustafës dhe Shalës, të akuzuar për krime lufte janë edhe ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ish-kreu i Partisë Demokratike të Kosovës, Kadri Veseli, ish-anëtari i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, Rexhep



Selimi, dhe ish-zëdhënësi i UÇK-së, Jakup Krasniqi. Gjyqi ndaj tyre është duke vazhduar.

Më herët nga Dhomat e Specializuara në Hagë janë dënuar ish-krerët e Organizatës së Veteranëve të UÇK-së, Hysni

Gucati dhe Nasim Haradinaj, për pengim të administrimit të drejtësisë, por më pas janë liruar me kusht.

Zjarre pranë zonës turistike në Shëngjin, evakuohen banorët

SHËNGJIN, 30 KORRIK - Autoritetet në Shqipëri raportojnë për përhapje të zjarreve në qytetin bregdetar të Shëngjinit, ndërsa po punohet mbrojtja e banesave dhe hoteleve. Autoritetet kanë thënë se janë evakuuar banorët afër zonës së zjarreve, ndërsa pushuesit besohet se janë më larg asaj pjese.

Flakët në Malin e Shëngjinit kanë nisur që nga e shtuna pasdite dhe zjarri është rindezur në mëngjesin e hënës.

Për shkak të erës, izolimi i vatrave të zjarrit aktualisht është i pamundur.

Në një njoftim të Prefekturës së Lezhës, mëngjesin e së martës, theksohet se "vatra e zjarrit në fshatin Mal Shëngjin ka dalë plotësisht jashtë kontrollit". Sipas njoftimit, gjatë gjithë natës kanë operuar 20 mjete zjarrfikëse me personel përkatës në përpjekje për t'i lokalizuar flakët.



Pos nga Lezha, mjetet zjarrfikëse kanë mbërritur edhe nga Mirdita, Tirana, Kamza, Berati, Fieri, Lushnja, Vau i Dejës si dhe Shkodra. "Me mjetet dhe efektivët zjarrfikës po punohet për mbrojtjen e

banesave dhe hoteleve. Deri tani është bërë e mundur që këto objekte të mos preken nga zjarri", është thënë në njoftimin e Prefekturës. Institucioni i Prefekturës së Lezhës thekson se, pavarësisht

prej angazhimit të të gjitha këtyre forcave, është e pamundur vënia nën kontroll të zjarrit dhe se rrezikohen shumë biznese, por dhe shtëpi banimi. Ministri i Brendshëm në detyrë, Taulant Balla, ka shkruar në

"Facebook" se situata është tepër e vështirë. "Policia e Shtetit, përmes Forcës Kombëtare të Sigurisë, po evakuon banorët", ka bërë me dije Balla mbrëmë pas mesnate. Një ditë më parë Ministria e Mbrojtjes e Shqipërisë njoftoi se në 24 orët e fundit ishin verifikuar 30 vatra zjarri, nga të cilat 22 janë shuar.

Mbrëmjen e së hënës është shuar zjarri në fushën e grumbullimit të mbeturinave në periferi të Vlorës, që ishte aktiv prej disa ditësh. Për vënien nën kontroll të kësaj vatre zjarri është nevojitur ndërhyrja e ushtrisë. Zjarri shkaktoi re të mëdha tymi dhe erë të pakëndshme të cilat u përhapën në gjithë qytetin e Vlorës në kulmin e sezonit turistik.

Autoritetet kanë bërë me dije se 1 300 zjarrfikës në gjithë vendin nuk e përballojnë situatën e zjarreve.

Fillojnë aktivitetet "Faleminderit Mërgatë"

PRISHTINË, 30 KORRIK - Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës ka bërë hapjen e aktiviteteve tërëditore që i dedikohen mërgatës në 25-vjetorin e çlirimit të Kosovës, në shenjë falënderimi dhe mirënjohje për kontributin e jashtëzakonshëm.

Në sheshin "Skënderbeu" në Prishtinë janë hapur tashmë tendat me lojra atraktive për

fëmijë, tendat e informimit, ku qytetarët mund të informohen rreth aktiviteteve që MPJD ia ka dedikuar mërgatës, si platforma Shijo Kosovën, platforma Made In Kosova (MIK).

Gjithashtu te këndet e informimit qytetarët kanë hapësirë për t'u njoftuar për shërbimet konsullore që ofrohen nga MPJD dhe misionet diplomatike nëpër botë, vizat, si dhe uljen e tarifave

për shërbimet konsullore, vendim ky që ka hyrë në fuqi pak ditë më parë.

Të gjithë qytetarët nga diaspora që ende nuk janë regjistruar mund ta kryejnë regjistrimin online, i cili për mërgatën është i hapur deri më 31 gusht të këtij viti.

Përveç pikave informuese, në shesh janë hapur edhe kënde për ushqim dhe pije.





Pozita e komisionarit të Zgjerimit të BE-së bëhet sërish tërheqëse

Menjëherë pasi Parlamenti Evropian, më 18 korrik, ka konfirmuar Ursula von der Leyenin në pozitën e presidentes së Komisionit Evropian edhe për një mandat të ri pesëvjeçar, kanë filluar kalkulimet se kush do t'i ketë pozitën kryesore në kolegjin e ri të komisionarëve, siç njihet Komisioni Evropian

BRUKSEL, 30 KORRIK - Menjëherë pasi Parlamenti Evropian, më 18 korrik, ka konfirmuar Ursula von der Leyenin në pozitën e presidentes së Komisionit Evropian edhe për një mandat të ri pesëvjeçar, kanë filluar kalkulimet se kush do t'i ketë pozitën kryesore në kolegjin e ri të komisionarëve, siç njihet Komisioni Evropian. Sipas traktateve themelore të BE-së, Komisioni Evropian duhet t'i ketë aq anëtarë sa ka vende anëtare BE-ja, që do të thotë se secili vend anëtar ka një komisionar. Kur emërohen në pozitën e komisionarëve, ata duhet t'i shërbejnë BE-së dhe jo vendit prej nga vijnë. Por, megjithatë, vendet anëtare synojnë dhe llobojnë fuqishëm që komisionarët e tyre të kenë pozitën sa më të rëndësishme. Pozita kryesore në Komisionin Evropian konsiderohen, zakonisht, ato që kanë të bëjnë me financa, bujqësi, fonde, tregti dhe energji. Edhe pse në BE nuk ka pozitë të komisionarëve që janë të parëndësishme, ndikimi i atyre që merren me resorë si kultura, edukimi, shëndetësia dhe disa fusha të tjera, është më i vogël. Kjo jo për faktin se këto fusha nuk janë të rëndësishme, por më shumë për shkak se ato janë kryesisht kompetenca të vendeve anëtare dhe Komisioni Evropian ka më pak ndikim në to. Kësaj radhe ka shumë interes

nga vendet anëtare që kandidati i tyre ta marrë pozitën e komisionarit të Zgjerimit të BE-së. Situata nuk ka qenë kështu para pesë vjetësh. Që nga viti 2004, kur ka ndodhur zgjerimi i madh i Bashkimit Evropian me dhjetë anëtarë të rinj, pozita e komisionarit të Zgjerimit nuk është konsideruar si i rëndësishëm. Atëkohë është kuptuar se në procesin e zgjerimit mbeten vetëm vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor dhe ato janë shumë larg anëtarësimit, andaj komisionari i Zgjerimit nuk do të mund të kishte ndonjë sukses të konsiderueshëm në mandatin e tij. Nga viti 2007, kur në BE janë anëtarësuar Rumania dhe Bullgaria, si dy vende që kanë qenë pjesë e valës së madhe të zgjerimit, vetëm Kroacia ka arritur të bëhet anëtare e këtij blloku në vitin 2013. Për t'i dhënë pak më shumë rëndësi kësaj pozite, komisionari i Zgjerimit ka marrë mbi vete edhe politikën ndaj fqinjëve të BE-së. Por, kjo nuk ka pasur ndonjë vlerë të madhe, pasi me ato vende, edhe ashtu, është marrë përfaqësuesi i lartë për Politikë të Jashtme dhe Siguri, që me automatizëm është edhe zëvendës-president i Komisionit Evropian. Në vitin 2019 nuk ka pasur ndonjë interes të madh nga vendet anëtare të BE-së që

kandidati i tyre ta merrte pozitën e komisionarit të Zgjerimit dhe ai i është dhënë Hungarisë. Ky nuk është parë si mesazh i mirë nga mbështetësit e zgjerimit, pasi Hungaria, edhe atëherë, ka pasur probleme në raportet me BE-në, për shkak të dyshimeve se ky vend ka shkelur parimet e sundimit të ligjit. Tash kur po përfundon mandati aktual i komisionarit të Zgjerimit dhe Fqinjësi, Oliver Varhelyi, shumë diplomatë vlerësojnë se ai, sado që ka vepruar në mënyrë korrekte, shpesh e ka ndjekur edhe linjën politike të kryeministrit hungarez Viktor Orban. Kjo, sipas disa diplomatëve të BE-së dhe Parlamentit Evropian, është shprehur sidomos në raportet me Serbinë. Arsyet përse pozita e komisionarit të Zgjerimit tani ka më shumë peshë janë të shumta, sipas diplomatëve të BE-së me të cilët ka biseduar Radio Evropa e Lirë. Në proces të zgjerimit tani janë dhjetë shtete. Pos gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor - Kosovës, Maqedonisë së Veriut, Malit të Zi, Shqipërisë, Serbisë dhe Bosnje e Hercegovinës - në proces janë edhe Ukraina, Moldavia dhe Gjeorgjia. Turqia - edhe pse pakkush beson se ajo mund të jetë ndonjëherë anëtare e BE-së - formalisht është ende vend me status kandidat. Derisa këto vende ose janë kandidatë, ose i kanë nisur negociatat e anëtarësimit, Kosova vetëm se ka aplikuar për anëtarësim në BE në fund të vitit 2022 dhe ende nuk ka marrë përgjigje. Me të gjitha këto vende do të merret komisionari i Zgjerimit dhe, për këtë, do të ketë përgjegjësi edhe për një buxhet

shumë më të madh se më parë. Meqë Ukraina - e cila për më shumë se dy vjet është nën pushtimin e plotë rus - pritet të jetë tema kryesore për BE-në edhe për një kohë, kjo e bën procesin e zgjerimit edhe më atraktiv për politikanët dhe vendet që duan të kenë ndikim. Edhe von der Leyen, gjatë fjalimit para Parlamentit Evropian, e ka përmendur procesin e zgjerimit si një prioritet të lartë të saj dhe si "imperativ gjeopolitik" të Bashkimit Evropian. "Kremtimi i 20-vjetorit të zgjerimit më të madh të BE-së na ka mundësuar të reflektojmë mbi këtë proces, që është dëshmuar si sukses për ato vende dhe për BE-në në tërësi. Historia na thërret përsëri dhe BE-ja ka një zgjedhje për ta bërë për të ardhmen e saj. Unë besoj se është një imperativ moral, politik dhe gjeostrategjik, që ta kompletojmë unionin tonë, në përputhje me premtimet që i kemi dhënë në bazë të traktateve", ka shkruar von der Leyen në udhëzimet e saj. Ajo ka thënë se në një botë ku ekzistojnë fuqitë e mëdha, një union më i fortë dhe më i zgjeruar i jep Evropës një peshë më të madhe në skenën globale. Ka përsëritur se procesi i zgjerimit do të mbetet i bazuar në meritat individuale të atyre që duan të hyjnë në Bashkimin Evropian. "Ky nuk do të jetë një rrugëim i lehtë. Anëtarësimi në BE do të jetë gjithmonë i bazuar në merita dhe secili kandidat do të vlerësohet në bazë të progresit në përmbushjen e kriterëve. Do t'i rrisim përpjekjet për t'i përgatitur vendet kandidatë, në veçanti përmes investimeve dhe reformave me planin e rritjes për Ballkanin Perëndimor dhe mjetet për Ukrainën", ka thënë

von der Leyen. Ajo ka përmendur, po ashtu, integrimin e vendeve në procesin e zgjerimit edhe në tregun unik të BE-së dhe mundësinë që t'i shfrytëzojnë edhe fondet e BE-së. Von der Leyen ka përsëritur se sundimi i ligjit do të mbetet gurthemel i politikës së zgjerimit. Qysh më herët, ajo ka premtuar se nëse rizgjidhet presidente e Komisionit Evropian, do të emërojë një komisionar të përkushtuar për ta çuar përpara procesin e zgjerimit. Ajo ka thënë se nuk duhet të ketë dyshime në mundësitë e BE-së për të pranuar anëtarë të rinj dhe këtë, sipas saj, e ka dëshmuar edhe përvoja e deritashme. Gjatë javëve të ardhshme, ajo do t'i pranojë nga qeveritë e vendeve anëtare emrat e kandidatëve të emëruar nga to për komisionarë. Pasi t'i ketë të gjithë emrat, ajo do t'ua caktojë resorët. Pritet janë që komisionari i Zgjerimit të jetë veç për zgjerim, e jo siç ka qenë deri më tash - për zgjerim dhe fqinjësi. Gjatë vjeshtës, të gjithë kandidatët do të kalojnë procesin e dëgjimit dhe konfirmimit në komisionet përkatëse të Parlamentit Evropian. Kandidati për komisionar të Zgjerimit do të duhet ta sigurojë mbështetjen e Komisionit për politikën e jashtme. Në fund, pasi individualisht ta marrin notën kaluese, të gjithë komisionarët do të votohen për përbërjen komplete të Komisionit Evropian. Plani ideal për të cilin flitet në BE, është që ekipi i ri i Komisionit Evropian, i udhëhequr përsëri nga presidentja Ursula von der Leyen, të jetë gati për ta nisur mandatin më 1 nëntor.

Demokrasi Plus: Komuna e Prishtinës shkeli Ligjin e Prokurimit Publik në kontratën 12 milionëshe për shërbimin “Arkitekti i qytetit”

PRISHTINË, 30 KORRIK - Përmes konferencës për medie Demokrasi Plus (D+) ka paraqitur gjetjet e hulumtimit rreth kontratës “Shërbimi i Arkitektit të Kryeqytetit”.

Gjatë prezantimit u theksua se komuna e Prishtinës ka shkëlur ligjin në kontratën 12 milionëshe për “Shërbimi i Arkitektit të Kryeqytetit”, duke caktuar në komision të vlerësimit të ofertave një person i cili nuk ishte pjesë e komunës së Prishtinës.

Ardit Dragusha, hulumtues në Demokrasi Plus, ka theksuar se ekziston dyshimi i bazuar për konflikt të interesit. “Anëtar i komisionit për vlerësimin e tenderëve, z. Kreshnik Ferizi, nuk ishte pjesë e Komunës së Prishtinës, duke qenë se kontrata e tij me Komunën e Prishtinës kishte përfunduar me datën 31.12.2022, konfirmuar nga Zyra e Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës. Komisioni i vlerësimit të tenderit për kontratën ‘Shërbimi i Arkitektit të Kryeqytetit’, përfundoi raportin dhe vlerësimin e ofertave me datën 29.05.2023, pesë muaj pas përfundimit të angazhimit të z. Kreshnik Ferizit me Komunën e Prishtinës”, ka thënë ai.

Dragusha ka theksuar se rregullorja e Prokurimit Publik



përcakton se autoritetet kontraktuese kanë të drejtë të angazhojnë ekspert të jashtëm në rastet kur kërkohet njohuri dhe ekspertizë e veçantë teknike dhe që ekspertët e tillë nuk janë në dispozicion brenda autoritetit kontraktues. “Mirëpo, z. Kreshnik Ferizi, nuk ishte as i angazhuar as si ekspert i jashtëm në kohën kur mori pjesë në

komisionin për vlerësimin e ofertave për këtë tender”, ka thënë ai.

Sipas Demokrasi Plus, përveç pjesëmarrjes së paligjshme në komision të vlerësimit të tenderit, ekziston dyshimi i bazuar për konflikt të interesit, duke qenë se grupi i operatorëve ekonomikë “Shërbimi i Arkitektit të Kryeqytetit (Ardi CC L.L.C;

Anarch Sh.PK) të cilët u shpallën fitues nga komisioni vlerësues, ku anëtar ishte Kreshnik Ferizi, ofertuan me dokumentacion, ku vetë Kreshnik Ferizi figuronte bashkëpunëtor i kompanisë “Anarch Sh.PK”. “Bazuar në këto të dhëna, D+ i bën thirrje Komunës së Prishtinës të bëjë anulimin e kësaj kontrate, si dhe prokurorisë të ndërmarrë

veprime për të hetuar të gjitha aspektet e këtij aktiviteti të prokurimit, duke përfshirë procesin e vlerësimit, kriteret e përzgjedhjes dhe çdo konflikt të mundshëm interes. Garantimi i transparencës, llogaridhënies dhe integritetit në këtë çështje është thelbësore për ruajtjen e besimit të publikut”, ka thënë Dragusha.

Kërkohet nga kryeprokurorët efikasitet më i lartë në trajtimin e rasteve të pasurive të sekustruara dhe të konfiskuara



PRISHTINË, 30 KORRIK - Ushtruesi i detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, Besim Kelmendi, ka mbajtur kolegjin e rregullt me të gjithë kryeprokurorët e prokurorive të vendit, përfaqësues të prokurorive dhe prokurorët e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, ku kanë marrë pjesë edhe përfaqësuesit e Ambasadës së ShBA-së në Kosovë.

Kryeprokurori Kelmendi ka diskutuar për raportet e prokurorive të vendit lidhur me rezultatet e prokurorëve për rastet që kanë të bëjnë me

pasuritë e sekustruara dhe të konfiskuara të cilat janë përdorur për kryerjen e veprave të ndryshme penale apo janë përfitur nga vepra penale e të cilat gjenden në depon e Agjencisë për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar (AAPSK).

Lidhur me këtë, Kryeprokurori i Shtetit ka kërkuar nga kryeprokurorët e prokurorive efikasitet më të lartë në trajtimin e këtyre rasteve në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale dhe ligjeve të tjera në fuqi ku, mes të

tjërash, është parashikuar edhe mundësia e shitjes së automjeteve të sekustruara dhe të konfiskuara apo edhe e shfrytëzimit të tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi, krejt me qëllim të parandalimit të pasojave që mund t'i bëhen buxhetit të shtetit për shkak të mosveprimit adekuat të prokurorëve.

Po në takim u diskutua edhe mundësia e pjesëmarrjes së prokurorëve të shtetit në trajnimet e Akademisë së Drejtës Evropiane (ERA) si dhe çështje të tjera profesionale.

Diskutohet për bashkëpunimin ndërmjet Zyrës për Rikthim të Aseteve dhe EULEX-it

PRISHTINË, 30 KORRIK - Udhëheqësi i Zyrës për Rikthim të Aseteve (ZRA), prokurori i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, Bahri Hyseni, ka pritur në takim monitoruesin Tematik të EULEX-it për Veprat Penale të Korrupsionit, Albert Effendi Van Nunen Karioen. Temë

kryesore e këtij takimi ndërmjet udhëheqësit të ZRA-së dhe monitoruesit të EULEX-it ishte diskutimi dhe informimi për detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrës për Rikthim të Aseteve si dhe bashkërendimi i punës me aktorët ligjzbatues dhe me partnerët ndërkombëtarë.

Karioen u zotua se është i gatshëm të ndihmojë dhe ta japë kontributin në dhënien e këshillave dhe gjetjen e praktikave më të mira për funksionimin sa më efikas të Zyrës për Rikthim të Aseteve e cila funksionon në kuadër të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit.



Dejona Mihalin për kryebashkiake të Himarës



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Hat-tricke bërjes m...: Albin Kurti që absolutisht po e përjeton pushtetin mbi pozitën duke i shndërruar në roqëtarë pa dinjitet, të njëjtën gjë po përpiqet ta bëjë edhe me opozitën duke iu premtuar zgjedhje të parakohshme dhe koalicione paszgjedhore. Presidenten Sherif-e Osmani e ka defaktorizuar aq shumë duke e shndërruar në "holandezen fluturuese" që shkon në çdo kanaxheq ndërkombëtar, pa prodhuar asnjë rezultat konkret për Kosovën. Punët e Sherif-e Osmanit janë teknike kurse vendimmarrja qind për qind është në duart e Albinit. Kjo farë presidente, me dhëmb, mish dhe pa shpirt po mundohet të fitojë edhe një mandat. Është në gjendje të bëjë çdo gjë për ta fituar edhe një mandat. As tani nuk guxon ta kundërshtojë Albinin për asgjë hiç dhe disa "shqelma" që i shpërndan janë më shumë për t'i hyrë në hatër Albinit, se për ta rivalizuar atë. Presidente Sherif-e Osmani nuk pati guxim as për t'u deklaruar për pornografinë informative të shtëpisë publike në Kosovë e quajtur RTK (Radio Televizioni i Kurtit), as për të kundërshtuar bordin e LV-së në RTK e as drejtorin militant të LV-së në këtë shtëpi publike pornografike. Me ligjet aktuale pornografia në Kosovë është e denueshme, me ligjet e LV-së pornografia është vlerë e shtuar morale, politike dhe kombëtare. Këtë hyrje e bëra shkaku se po përflitet që artikullin kundër Ilir Mirenës, ushtar i UÇK-së, tash në krye të Periskopit dhe Berat Buzhalës, veteran i gazetarisë kosovare, tash në krye të Nacionales e paska shkruar Dejona Mihali, kurse dorën e fundit ia paskan dhënë Halil Thaçi dhe Dilmal Basha, bashkë me këta ekstazitë e Prizrenit. Sa isha në Sarajevë qarkullonte një barsolëtë se si ndjehej boshnjaku midis cungave dhe rrënjëve të kalbura?! Përgjigja ishte se ndjehej si intelektual. Duket kështu ndjehet edhe Dejona Mihali midis cungave të LV-së, si superintelektuale dhe patriote. Në luftimin e analfabetizmit politik, varfërisë

njerëzore, mjerimit moral dhe mohimit kombëtar, Dejona Mihali e përdorë metodën Daci Bao apo gazetë muri që e përdornin autokratët kinezë në kohën e Revolucionit Kinez për të edukuar dhe riedukuar masat e gjëra popullore. Dejona Mihali është miti në LV dhe konsiderohet eminenca gri e të gjitha sulmeve kundër vlerave kombëtare dhe politike në Kosovë pasi që Shqipëria e ka pamundësuar aktivitetin e saj. Dështoi keq në zgjedhjet kundër Edi Ramës, bashkë me Grupin Anarkist të Tiranës kurse në Kosovë u shpallë persona non grata nga autoritetet e sigurisë. Me marrjen absolute të pushtetit, LV e personifikuar në karizmën dhe fuqinë politike të Albin Kurtit, përmes roqëtarëve të posteve më të larta si Sherif-e Osmani dhe Donika Shvarc Katrani, në kundërshtim me ligjin e amnistuan këtë andare greke dhe lavatriçe e LV-së duke ia dhënë nënshtetësinë kosovare. Merreni me mend, nga non grata në një person të nderuar nga kreu i shtetit!!! Në të njëjtën mënyrë autoritetet shqiptare patën pajisur me pasaporta bijtë dhe bijat e udbashëve të Kosovës, të prokurorëve dhe gjykatësve që kishin dënuar me qindra mijëra patriotë shqiptarë. Madje kishin ndarë edhe mirënjohje për ta në kohën kur për Bacën Adem Demaçi është dashur të pritej disa muaj deri sa u pajis me pasaportë shqiptare. Jam dëshmitar okular sepse isha në presidencën e Shqipërisë për këtë çështje, jo vetëm një herë. Nuk ka mbetur horr apo antikombëtar nga Kosova që nuk është pajisur me pasaportë shqiptare e pse mos të pajiset Dejona Mihali me pasaportë kosovare?!

Përzgjedhjet në Himarë: Albin Kurti, përmes kukullës të quajtur Besnik Bislimi e forcoi rrogëtarllëkun në Luginë të Preshevës duke korruptuar materialisht dhe moralisht disa politikuaj të Luginës dhe duke shkaktuar përçarje të panevojshme. Realisht, Luginën e dobësoi në atë masë që shqiptarët

sot luftën kryesore e bëjnë duke luftuar njëri-tjetrin e jo duke kundërshtuar Vuçiqin. Të njëjtin model e përdori në Maqedoninë e Veriut duke përkrahur Besnik Kojen, Arben Travarin, Gashin, Mexhitin dhe mbetjet tjera mortore në aspektin kombëtar dhe politik. Rezultatet janë të dukshme, defaktorizimi i shqiptarëve në aspektin e përfaqësimit politik dhe kombëtar. Krahasoni pozitën dhe fuqinë politike që e kishin shqiptarët në kohën e Ali Ahmetit dhe tash në kohën e Besnik Kojes, roqëtarit besnik të Albin Kurtit dhe të Mickoskit. Albini nuk ka lënë gur pa lëvizur për të luftuar Hashim Thaçin dhe Kadri Veselin në Kosovë, Edvin Ramën në Shqipëri, Donald Trampin në Amerikë, Putinin në Rusi dhe Ali Ahmetin në Maqedoni të Veriut.

Kryesisht i ka luftuar dhe i lufton udhëheqësit e luftës çlirimtare dhe përkrahësit e tyre. Nën maskën e përkrahjes, e ja sulmuar edhe Bacë Adem Demaçin, sidomos pasi hyri në Kuvend të Kosovës. Përkujtimi për Bacën Adem Demaçi është meskine dhe bizantinizëm primitiv, askush normal nuk e beson këtë. Tash, për ta kompletuar hat-trickun e bërjes m..., Albini duhet ta propozojë Dejona Mihalin për kryebashkiake të Himarës. Aty, si fitues i zgjedhjeve të blera ishte kriminel, Fredi Beleri, vrasës i ushtarakëve shqiptarë në Peshkopi dhe luftëtar për Himarën, si kryeqytet i Vorio Epirit, benjamin ky i Sali Berishës dhe Like Metës. Po ky Beleri, si kriminel dhe terrorist i zgjedh eurodeputet, si kandidat i Micotakis. BE-ja po zbaton standarde të dyfishta, në vendet tjera kërkon standarde të larta të zbatimit të ligjit kurse në BE, kriminelët dhe terroristët i zgjedhë deputet, nuk keni shembull më bindës se rasti Beleri. Kandidati i pozitës në Shqipëri, lexo i Edi Ramës është Vangjel Tavo, grek i cili nuk e kundërshton haptas Vorio Epirin. Tash, në vend të hidraulikut injorant, Fredi Beleri, opozita e ka propozuar si kandidat, Petro Gjukurinë, një

luftëtar transatlantik për Vorio Epirin si dhe latifundist në Himarë. Qartazi, çështje e Himarës është luftë për tokë, prona afër detit dhe askush normal nuk beson se Himara mund të bëhet pjesë e Greqisë. As teknikisht e as territorialisht. As edhe simbolikisht. Besoj se në kakofoninë e interesave greke, Dejona Mihali do të ishte kandidate e përkryer, si nga përcaktimi kombëtar, politik dhe interesit rajonal. Si dëmtuese e madhe e interesit kombëtar në Shqipëri dhe në Kosovë, si intrigante dhe konspiracioniste, do të konsiderohej si vlerë e shtuar e Micotakis apo si motër e vogël e Fredi Belerit. Dejona Mihali ka dëmtuar rëndë patriotët e vërtetë të LV-së duke i marginalizuar apo edhe duke i përjashtuar nga kjo parti. Ka shpifur paskrupullt kundër ish të burgosurve politikë, kundër UÇK-së dhe udhëheqësve të saj që tani po mbahen pengje në Hagë. Ka shpifur kundër të gjithë atyre që janë kundër Liderit Suprem duke ia disajnuar listën për deputetë apo kabinetin qeveritar me injorantë, mashtrues, rrenca dhe hajdutë ordiner. Nuk ka lënë pore pa i futur turinjte e sidomos është një "amazonë" kundër mediave të lira dhe të pavarura. Rasti më eklatant është ky me RTK-në ku pandershmërisht sulmon ata që nuk pranuan të bëhen pjesë e prostitucionit informativ sikur që edhe më pandershmërisht i mbron ofruesit e shërbimeve në këtë shtëpi të vetme publike me letra në Kosovë, RTK. Forca Dejona, trashëgimtare e Fredi Belerit.

Muaji i rëfimeve të të burgosurve politikë në TV DUKAGJINI: Gjatë muajit gusht 2024, në TV Dukagjini do të emitohej 20 intervista të të burgosurve dhe të burgosurve politikë shqiptare që kanë kaluar nëpër të gjithë rrahët e Ferrit për shkak të aktivitetit politik dhe kombëtar. Dhunuesit brutal gjatë hetimeve ishin kryesisht shqiptarë, bashkëpunëtorë të UDB-së dhe KOS-it, sikur që ishin edhe shumë dëshmitarë, avokatë, prokurorë dhe

gjykatës. Ermal Panduri, në mos të ketë bërë asgjë në jetën e tij si gazetar, me këto intervista që vet i ka bërë, me shumë emocione dhe dhimbje, e ka hapë një dritare për të depërtuar në mozaikun e vuajtjeve të mijëra e mijëra të burgosurve politikë shqiptarë që kaluan shekuj e shekuj burgje në llogoret e Jugosllavisë dhe të Serbisë, një numër i të cilëve u mbyten në burgje gjatë torturave sikur që u paafësuan për të krijuar familje apo mbetën invalidë të përjetshëm. Ermal Panduri në këto 20 intervista, përmes rëfimeve nga rrahët e Ferrit, e krijon mundësinë që shikuesit të njofohen me listën e xhelatëve të UDB-së, KOS-it dhe OZNËS, që flisnin shqip por që dhunën dhe brutalitetin e bënin më ashpër se vet serbët, në emër të serbëve. Pasi të përfundojnë këto 20 intervista e që janë vetëm një pikë uji nga deti i vuajtjeve shqiptare, shikuesit do të binden se pasardhësit biologjikë të kriminelëve të UDB-së, KOS-it OZNËS janë rehatuar si është më së miri në të gjitha institucionet e Kosovës që nga përfundimi i luftës kurse kulmin e sefasë po e bëjnë në qeverinë Kurti. Gjithashtu do të binden se pasardhësit e të burgosurve politikë, hiç këtu të burgosur politikë llaskuc që kanë përfituar nga të gjitha qeveritë, sot luftojnë për mbijetesë. Ky është realiteti sot në Kosovë. Shtresa që më së shumti ka sakrifikuar sulmohet nga Dejona Mihali dhe trushpëlarët e saj, nga nipi politik i Arkanit që kinse merret me arsim, nga vjedhësi i parave të Bacë Adm Demaçit që gjithashtu kinse merret me arsim dhe nga mbetjet biologjike, "kombëtare" dhe politike të udbashëve, kosistëve dhe oznashëve. Të tillë ka deputetë, ministra, ambasadorë, udhëheqës të ndërmarrjeve publike dhe bordeve si dhe mediave që kanë hyrë nën bisht të këtij dhe pushteteve të tjera. JETO, PËR TË RRËFYER, siç thoshte At Zef Pëllumbi! Për hir të kujtesës historike dhe kombëtare! Për gjeneratat e ardhshme që bukës i thonë bukë e ujti, ujë.

Në bjeshkën e Roshkodolit policia identifikon një vend me bimë narkotike

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 30 KORRIK - Policia e Kosovës, në vazhden e angazhimeve të shtuara, gjatë zbatimit të një plani operativ përmes pajisjeve teknologjike, në bjeshkën e Roshkodolit në komunë të Deçanit, në një zonë të thellë malore, ka lokalizuar një vend ku dyshohej se po kultivoheshin bimë narkotike. Njësitë e specializuara kufitare së bashku edhe me Njësinë e Antidrogës kanë shkuar në lokacionin e dyshuar, ku në vendin e ngjarjes janë gjetur katër

sera, në të cilat kishin qenë të mbjella bimë të dyshuara narkotike të llojit marijuanë, të cilat dyshohet se ishin djegur nga persona të dyshuar.

Në bazë të shikimit të vendit të ngjarjes dyshohet se kanë qenë të mbjella rreth 300 bimë narkotike të madhësisë nga/deri në 1-2m gjatësi.

Lidhur me rastin njësitë përkatëse në vendin e ngjarjes kanë marrë provat materiale si mostra të bimëve narkotike, një armë AK 47 me 32 copë fishekë dhe një fishekë i kalibrit për armë të gjuetisë etj.

Provat materiale të bimëve

narkotike që kanë mbetur të padjegura, pas konsultimit me prokurorin përkatës, janë asgjësuar në vendin e ngjarjes, ndërsa pas konsultimit me prokurorin kompetent është hapur rasti për veprat "Kultivim i bimëve narkotikëve" dhe "Posedim i paautorizuar i armëve dhe municioneve".

Në lidhje me rastin, meqenëse zona ndodhet afër kufirit, është komunikuar edhe Policia Kufitare e Republikës së Shqipërisë dhe ajo e Malit të Zi, të cilat kanë aktivizuar njësitë e tyre në zonat përkatëse të shteteve të tyre.

Klinika e Radiologjisë pranon një CT, donacion nga ShBA-ja

PRISHTINË, 30 KORRIK - Klinika e Radiologjisë ka pranuar një donacion nga Zyra për Mbrojtje dhe Bashkëpunim në Ambasadën Amerikane në vlerë afër 500 mijë euro, raporton Ekonomia Online.

Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, tha se ky investim është tejet i rëndësishëm për pacientët, ndërsa falënderoi Zyrën për Mbrojtje dhe Bashkëpunim në Ambasadën Amerikane.

Vitia këtë ditë e ka vlerësuar të rëndësishme për shëndetësinë në vend dhe shtoi se pacientët do të marrin shërbime të sigurta përmes teknologjisë më të

avancuar në fushën e radiologjisë. "Dua ta shpreh kënaqësinë për Ambasadën e ShBA-së që për vite me radhë ka qenë aleate e mbështetëse e rrugës sonë. Në kuadër të këtij bashkëpunimi, edhe në ditën e sotme duhet ta shënojmë si të veçantë për shëndetësinë", tha Vitia, teksa tregoi edhe për specifikat e kësaj aparature.

"Do të ketë efekt në diagnostikimin emergjent në raste emergjente. Investimi kap shifrën 499 mijë eurosh dhe ky donacion do të ndihmojë në diagnostikimin e pacientëve tanë. I rëndësishëm është edhe trajtimi

i personelit tonë. Stafi ynë është i përgatitur për ta përdorur këtë pajisje", u shpreh Vitia.

I pranishëm në këtë ceremoni ishte edhe ambasadori amerikan Jeffrey Hovenier, i cili ka treguar rëndësinë e këtij donacioni. "Kënaqësi të dhuroj një skaner të ri CT për Shërbimin Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës me mbështetjen e Komandës Evropiane të ShBA-së (EUCOM). Ky skaner i ri do ta përmirësojë kujdesin e ofruar për të gjithë qytetarët. Një komb i shëndetshëm është një komb i fortë", ka thënë ambasadori amerikan.



IKShPK-ja jep këshilla për kujdes nga kafshimi i gjarprit



PRISHTINË, 30 KORRIK - Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik i Kosovës ka njoftuar se në Kosovë deri tani dihet se jetojnë katër lloje të gjarpërinjve, ndër ta edhe lloji helmues Vipera ammodytes (gjarpri i gurit, nepërka).

Sipas IKShPK-së, shumica e gjarpërinjve nuk janë të rrezikshëm për njerëzit. "Vetëm rreth 15 % e gjarpërinjve në mbarë botën mund të injektjnë helm kur kafshojnë. Këta gjarpërinj quhen helmues. Megjithatë, kafshimet e gjarpërinjve mund të shkaktojnë lëndime serioze dhe ndonjëherë

vdekje. Në Kosovë deri tani është e ditur se jetojnë 4 lloje të gjarpërinjve e ndër ta edhe lloji helmues Vipera ammodytes (gjarpri i gurit, nepërka). Nëse ju kafshon një gjarpër helmues, telefononi menjëherë në numrin 194, familjarët ose të afërmit tuaj, sidomos nëse zona e kafshuar nga gjarpri ndryshon ngjyrën, fryhet ose është e dhimbshme", ka njoftuar IKShPK-ja, duke njoftuar edhe për simptomat. "Shumica e kafshimeve të gjarpërinjve ndodhin në krahë, kyçe ose duar. Simptomat tipike të një kafshimi jo

helmues janë dhimbja, lëndimi dhe gërvishtjet në vendin e kafshimit. Pas një kafshimi helmues, gjarpri zakonisht ka dhimbje serioze dhe ndjeshmëri në vendin e kafshimit. Kjo mund të përkeqësohet në enjtje dhe mavijosje. Simptoma të tjera: Të përziera, frymëmarrje e vështirësuar dhe ndjenja e dobësisë, si dhe një shije e çuditshme në gojë. Ndonjëherë, një gjarpër helmues mund të kafshojë pa injektuar helm. Kjo quhet pickim i thatë", theksohet në njoftimin e IKShPK-së

Tahiri, pushtetit: U shëtitët boll, edhe foto e video keni bërë në Paris, tash a po merreni me minatorët e Trepçës?

PRISHTINË, 30 KORRIK - Shefi i grupit parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Besnik Tahiri, ka bërë një reagim lidhur me mosekzekutimin e pagave për muajin qershor për minatorët e Trepçës. "U shëtitët

boll, edhe foto e video bëtë në Paris, tash a po merreni me minatorët e Trepçës që janë pa rroga, me bllokadat e rrugëve gjithandej Kosovës, me pensionistët që po presin pas katër vjet qeverie me ua rritë

pensionet me dëmet ekonomike e me bllokadën ndërkombëtare. Punoni ndonjë gjë të hajrit, e jo veç me kontrata njëburimore e korruptive! Se di për besë çka do të flisni në fushatë", ka shkruar Tahiri në "Facebook".



Djegia e hamulloreve, Ministria e Bujqësisë: Paraqet kërcënim

PRISHTINË, 30 KORRIK - Duke qenë se jemi në fazën finale të korrjes shirjeve, ku pas procesit të korrjes së grurit, disa fermerë praktikojnë t'i djegin hamulloret (stërnishtat), Ministria e Bujqësisë ka dalë me një njoftim, duke theksuar se përmes djegies së hamulloreve mund të shkaktoni dëme në shtëpi, objekte të ndryshme, kultura të ndryshme bujqësore, pyje dhe toka pyjore duke shkaktuar dëme të mëdha dhe shpesh të pakthyeshme, siç kanë të bëjnë ato me dëme materiale dhe ndotjen e mjedisit përmes rritjes së dyoksidit të karbonit në atmosferë. "Për shkak të temperaturave të larta është nevojshme shtimi i vigjilencës dhe marrja e masave paraprake për ndalimin e ndezjes së hamulloreve në mënyrë që të pengoni shkaktimin e dëmeve për jetën e njeriut, objekte banimi, pyje dhe toka pyjore, etj. Në parcelat në të cilat nuk ekzistojnë mundësitë për ujtitje, duhet të merren masa në përkufizimin e parcelës, sidomos të tokave bujqësore që kufizohen me pyje dhe pranë tyre duke bërë lërim me brazda në 2-4 rinde në mënyrë që të pengohet përhapja e zjarrit në vendbanime dhe tokat përreth. Tek të njëjtat parcela, pas të korrave të grurit, kërkohet të merren masat agroteknike për lërimin e cektë të tyre duke krijuar kushte për dekompozimin e mbetjeve nga të korrat, e cila

preferohet sidomos të zbatohet pranë vendbanimeve, pyjeve dhe tokave pyjore. Lërimi i cektë ndihmon në përmirësimin e strukturës së tokës dhe rritjen e plleshmërisë të saj", ka njoftuar kjo ministri.

Sipas Ministrisë së Bujqësisë, djegia e hamulloreve dhe mbetjeve pas korrjeve (kashta) paraqet një potencial dhe kërcënim të madh të objekteve të banimit, bizneseve, pemishteve, pyjeve dhe tokave pyjore. "Po ashtu, si pasojë e djegies së hamulloreve vjen deri tek shkatërimi i florës dhe faunës që për habitat të tyre kanë tokat bujqësore dhe pyjore", ka njoftuar Ministria e Bujqësisë, e cila ka dhënë disa këshilla për fermerë lavërtarë. "Në parcela me mundësi ujtitje të fillohet me lërimin e tyre dhe fitoni dy të korrura brenda vitit nga e njëjta sipërfaqe. Kjo mundësohet sidomos pas korrjes së grurit ku mund të mbjellim kultura tjera, si: misër foragjer me vegetacion të hershëm për silazh, perime, lakra, preshi, etj. Mbjellja e kulturës së dytë shërben edhe për qarkullim bimor që ndikon në marrjen e rendimenteve më të larta të kulturave pasardhëse, zvogëlimin e barojave, uljen e ndikimit të sëmundjeve dhe dëmtuesve dhe pasurimin me materie ushqyese", thuhet në njoftim.

Më tej kjo ministri ka dhënë edhe këshilla për pronarët e pyjeve dhe




tokave pyjore. "Të ndërmerni masa preventive përmes shtimit të vigjilencës në vrojtimin, patrullimin në pronat e tyre, sidomos në rastet e shtrirjes së pyjeve në afërsi të tokave bujqësore. Gjithashtu, kërkohet që në rast zjarri në tokat bujqësore të ndërmerren hapa për shuarjen e tyre, njoftimin e institucioneve përkatëse emergjente dhe ofrimin e bashkëpunimit: Njësitë të zjarrfikëse, Policinë, Forcën e Sigurisë të Kosovës dhe institucioneve tjera si: Komuna,

Autoritet pyjore komunale, Drejtoritë Koordinuese të Agjencisë Pyjore të Kosovës, Drejtoritë e Parkut Kombëtar, Ministrinë përkatëse. Në parcelat pyjore si masë preventive këshillohet të ndërmerren masat e kultivimit të pyjeve përmes krasitjes dhe pastrimit nga degët e thata të drunjve, rrallimeve në kohën e duhur të grumbujve pyjor, hapja dhe mirëmbajtja e shtigjeve, rrugëve pyjore, hapja e brezave kundër zjarrit, pastrimin buzë rrugëve publike, hekurudhave,

shtrirjes së korridoreve të largpërçuesve, mirëmbajtjen dhe rregullimin e burimeve ujore, rrjedhave ujore, krijimin e rezervuarve ujor në zonat e thata etj", ka bërë me dije Ministria e Bujqësisë, duke theksuar se në zonat ku është i zhvilluar turizmi duhet të ndërmerren masa për përcaktimin e vendeve për ndezje të zjarreve, vendosje të shenjave paralajmëruese për rrezikun e zjarreve, ofrim të kushteve dhe ujtit për shuarje të zjarreve në vendet e përcaktuara.

Dërgohen në Kuvend emrat e dy kandidatëve për emërim në Bord të Trustit



PRISHTINË, 30 KORRIK - Komisioni për përzgjedhje të kandidatëve për anëtarë të Bordit Drejtues të FKPK-së, për pozitën anëtar me përvojë profesionale në përfaqësimin ose këshillimin e punëdhënësve në Kosovë dhe për pozitën anëtar me përvojë profesionale në përfaqësimin ose këshillimin e punonjësve apo përfaqësuesve të tyre në Kosovë, i përbërë nga guvernatori i BQK-së, Auditorja e Përgjithshme dhe ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, i propozoi Kuvendit për emërim dy kandidatë për anëtarë të Bordit Drejtues të FKPK-së.

Në njoftimin e BQK-së thuhet se për pozitën anëtar me përvojë profesionale në përfaqësimin ose këshillimin e punëdhënësve kanë aplikuar 13 kandidatë, prej të cilëve 6 kandidatë i janë nënshtruar intervistës. Edhe për pozitën anëtar me përvojë profesionale në përfaqësimin ose këshillimin e punonjësve apo përfaqësuesve të tyre kanë aplikuar 13 kandidatë, prej të cilëve 6 kandidatë i janë nënshtruar intervistës. "Prandaj, Komisioni bazuar në intervistimin e kandidatëve dhe kryerjes së verifikimeve të nevojshme, unanimisht vendosi që, konform Ligjit për Fondet

Pensionale, dy kandidatët e vlerësuar me më së shumti pikë të procedohen tek Kuvendi për emërim për anëtarë të Bordit Drejtues të FKPK-së: për pozitën anëtar me përvojë profesionale në përfaqësimin ose këshillimin e punonjësve apo përfaqësuesve të tyre propozohet: kandidati Ali Vitija, i vlerësuar me më së shumti pikë nga intervistimi (22.3 pikë nga 30 pikë) për pozitën anëtar me përvojë profesionale në përfaqësimin ose këshillimin e punëdhënësve propozohet: kandidati Arsim Bruçaj, i vlerësuar me më së shumti pikë nga intervistimi (24.7 pikë nga 30 pikë)", thuhet në njoftim.

Tërhiqet nga shitja njësia nr. 15 Apiko lokali (ish-depo) në Prishtinë

PRISHTINË, 30 KORRIK - Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) njofton se ka tërhequr nga tenderi i shitjes Njësinë nr. 15 Apiko lokali (ish-depo) në Prishtinë. Ky aset ishte paraparë për t'u shitur përmes Shitjes së Aseteve përmes Likuidimit nr. 67, e

cila do të mbahet më 31 korrik 2024, ndërsa tërheqja nga shitja është bërë me vendim të Bordit të Drejtorëve të AKP-së.

Lista e asetëve që janë në shitje përmes Shitjes së Aseteve nr. 67 përfshin asete të ndërmarrjeve shoqërore

nga regjione të ndryshme të Kosovës dhe mund të gjendet në uebfaqen e AKP-së.

Dorëzimi i ofertave do të mbahet më 31 korrik 2024 në sallën e "Grand Hotel"-it në Prishtinë, kur edhe do të mbahet ceremonia e hapjes së ofertave.



Një dekadë në pushtet, çfarë do të ndodhë me Maduron?

Nicolas Maduro, presidenti socialist që ka sunduar Venezuelën për më shumë se një dekadë, tani përballlet me sfidën më të madhe ndaj sundimit të tij. Në zgjedhjet presidenciale të ditës së diel, sipas sondazheve, sfidanti i tij Edmundo Gonzales pritet të fitojë thellë – nëse Maduro do e lejojë. Votimet, që pak gjasa ka të jenë të lira dhe të drejta, do u ofrojnë venezuelianëve të pakënaqur shpresë për të lënë pas shtetin socialist që themeloi Hugo Chavez, një çerek shekulli më parë.

Maduro, president i Venezuelës që kur Chavez ndërroi jetë në 2013, u ka mbijetuar sanksioneve, protestave masive, një qeverie hije të mbështetur nga SHBA, një kryengritjeje e madje edhe një grushti shteti. Ndërkohë, vendi i tij ka vuajtur izolimin, një kolaps ekonomik dhe një eksod masiv – kriza të cilat ai i ka përdorur për të shtrënguar kontrollin e tij.

Në disa tregues, Venezuela e cila është bekuar me rezervat më të mëdha të naftës në botë, ka qenë dikur vendi më i pasur i Amerikës së Jugut. Por mes viteve 2012 dhe 2020, ekonomia e saj u tkurr më shumë se e çdo vendi tjetër në historinë moderne. Inflacioni i lartë, dhuna e përhapur, mungesat e mallrave dhe shërbimeve, dhe një qeveri represive kanë nxitur më shumë se 7 milionë njerëz që të largohen, në atë që Kombet e Bashkuara e quajnë një prej krizave më të mëdha të migrimit në botë.

Për të kuptuar se sa shumë gjëra varen nga zgjedhjet e të dielës, ia vlen të rishikojmë ngjarjet që e sollën Venezuelën në këtë pikë.

Chavez ndërroi jetë, Maduro merr pushtetin

Dhjetor 2012: Chavez, një ish oficer i ushtrisë që udhëhoqi të ashtuquajturin revolucion socialist, e kishte drejtuar Venezuelën për 14 vite si president. Tashmë i sëmurë me kancer, presidenti shumë i dashur bën një dalje të fundit televizive, dhe cakton trashëgimtarin: Maduro, ish shoferi i autobusit që u shndërrua në lider sindikatash dhe që në atë kohë shërbente si zëvendës president i tij. Në 5 mars 2013, qeveria shpall vdekjen e Chavezit. Kushtetuta kërkonte që të mbaheshin zgjedhje brenda 30 ditësh.

Prill 2013: Në zgjedhjet për zëvendësimin e Chavezit, Maduro shpall një fitore të ngushtë përballë kandidatit të opozitës, Henrique Capriles. Ky i fundit kërkoi një rinumërim, duke përmendur parregullsi në votime. Nisin protesta në të gjithë

vendin, dhe forcat e sigurisë vrasin 43 demonstrues. Ekonomia pëson kolaps. Venezuelasit nisin të largohen.

Dhjetor 2015: Në të parën fitore të rëndësishme kundër Maduros, opozita fiton zgjedhjet që i mundësojnë të ketë kontrollin e Ansamblesë Kombëtare.

2016-2017: Një rënie e ngadaltë e ekonomisë që kishte nisur qysh në kohën e Chavezit, shndërrohet në një krizë humanitare. Keqmenaxhimi i qeverisë dhe rënia e çmimeve të naftës shkaktojnë mungesa në ushqime, ilaçe dhe mallra të tjera. Inflacioni rritet mbi 700%. Venezuelasit presin në radhë të gjata për ushqime. Fëmijët vdesin nga uria. Krimi i rrugës përhapet me shpejtësi. Ndërprerjet e energjisë bëhen pjesë e përditshmërisë. Miliona njerëz largohen – shumica në Kolumbi, të tjerë në Brazil, Ekuador dhe Kili. Disa edhe në SHBA.

Mars 2017: Gjykata e Lartë e Venezuelës, e mbushur me besnikë të Maduros, zhvesh nga kompetencat Ansamblenë Kombëtare që kontrollohej nga opozita dhe projektin një legjislativë të re. Opozita akuzon Maduron për organizim të një grushti shteti.

Prill 2017: Mijëra njerëz dalin në rrugë, në demonstrata antiqeveritare disa javore. Vendi zhytet në anarshi. Bandat proqeveritare të motoçiklistëve të quajtura "colectivos", u përgjigjen protestuesve me forcë vdekjeprurëse. Forcat e sigurisë vrasin më shumë se 100 njerëz. Maduro mbledh një ansamble speciale për të ribërë kushtetutën, duke i dhënë më shumë kompetenca vetes. Udhëheqësit e SHBA dhe Amerikës Latine paralajmërojnë se qeveria e tij po shkon drejt diktaturës. Administrata Trump kufizon qasjen e Venezuelës në sistemin financiar të SHBA.

Rritja e lëvizjes opozitare

Maj 2018: Qeveria mban zgjedhje presidenciale por ndalon partitë opozitare tradicionale që të nxjerrin kandidatë. Opozita bën thirrje për bojkotim të zgjedhjeve. Maduro shpall fitoren. Zgjedhjet dënohen ndërkombëtarisht si të parregullta.

Janar 2019: Juan Guaido, president i Ansamblesë Kombëtare të kontrolluar nga opozita citon kushtetutën, e cila vendos kreun e legjislativës si lider të vendit nëse një uzurpator mban peng funksionin. SHBA dhe më shumë se 50 qeveri të tjera njohin Guaidon si president të përkohshëm të Venezuelës. Maduro ndërpret marrëdhëniet diplomatike me Uashingtonin.



Administrata Trump ndalon blerjen e naftës venezueliane.

Shkurt 2019: Liderë të opozitës përpiqen të sjellin miliona dollarë ndihma në ushqime dhe ndihmë mjekësore për Venezuelën. Por Maduro e bllokoi, duke e quajtur një përpjekje të SHBA për të pushtuar vendin. Forcat e sigurisë dhe opozita e mbështetur nga SHBA kanë një përballje dramatike në kufi.

Mars 2019: Një ndërprerje energjie mbarëkombëtare zhyt në errësi të Venezuelës, për më shumë se një javë. Defektet e vazhdueshme në rrjetin e energjisë elektrike përkeqësojnë mungesat në ujë, duke i shtyrë disa banorë të përdorin ujërat e zeza. Ardhja e koronavirusit në 2020 e përkeqëson më shumë sistemin shëndetësor dhe ekonominë.

30 Prill 2019: Guaido shfaqet në bazën ushtarake të La Carlotas pranë Caracasit, për të shpallur një kryengritje. Në krah të tij janë mentorit i tij, udhëheqësi i opozitës Leopoldo Lopez, që ka dalë nga arresti shtëpiak i çliruar prej ushtarëve si dhe oficerë rebelë të ushtrisë. Ata u bëjnë thirrje ushtrisë dhe qytetarëve të Venezuelës të bashkohen me ta, për të rrëzuar diktaturën. Për disa orë, protestuesit mbushin rrugët e Caracasit dhe qyteteve të tjera. Por shumica e trupave i qëndrojnë besnikë Maduros, duke bërë që plani të dështojë.

Guaido do të deklaronte më vonë se opozita kishte llogaritur keq mbështetjen në radhët e ushtrisë. Ai vazhdon të bëjë thirrje për demonstrata, por pas dështimit të karvanit të ndihmave dhe rebelimit, pjesëmarrja nis të bjerë.

Janar 2020: Në një intervistë për Uashington Post, Maduro thotë se ka ardhur koha për bisedime të drejtpërdrejta me SHBA. Opozita humbet vull, dhe Maduro shtrëngon kontrollin përmes masave kundër koronavirusit dhe planeve të vaksinimit.

Maj 2020: Ish pjesëtari i Beretave të Gjelbra Jordan Goudreau dhe ish gjeneral-majori venezuelian Cliver Alcala lançojnë operacionin Gideon, një plan për të infiltruar në Venezuelë dhe kapur Maduron. Plani përfshin dy ish pjesëtarë të tjerë të Beretave të Gjelbra dhe shumë ushtarë venezuelianë në mërgim, të cilët janë grumbulluar dhe stërvitur në Kolumbi.

Por shërbimi i fshehtë i Maduros ka mundur të penetrojë tek organizatorët, dhe kur grupi mbërrin forcat e tij të sigurisë janë në pritje. Ata vrasin gjashtë pjesëmarrës dhe arrestojnë më shumë se 90, duke përfshirë dy ish pjesëtarë të Beretave të Gjelbra, Airan Berry dhe Luke Denman.

Maduro forcohet më shumë; afrohet SHBA

Mars 2022: Zyrtarë të administratës Biden udhëtojnë për në Caracas, për takime me qeverinë e Maduros. Është një ndryshim i madh nga qasja e administratës Trump, për të ushtruar presion maksimal. Përpjekja e administratës Biden synon pjesërisht shkëputjen e Caracasit nga miqtë e vet në Moskë, Pekin dhe Teheran dhe pjesërisht për të patur më shumë qasje në burime energjie, duke patur parasysh nisjen e luftës në

Ukrainë. Në Maj 2022, administrata nis të lehtësojë disa sanksione mbi naftën e Venezuelës.

Dhjetor 2022: Opozita shpërbën qeverinë hije të Guaidos. Një numër rekord venezuelianësh mbërrijnë në kufirin jugor të SHBA. Shumë prej tyre kanë kaluar nëpër rripin Darien, 60 milje, pa rrugë, i mbushur me kriminelë në xhunglën midis Kolumbisë dhe Panamasë, i cili lidh Amerikën e Jugut me Amerikën e Veriut.

Tetor 2023: Administrata Biden lehtëson sanksionet mbi naftën, gazin dhe floririn në këmbim të premtimit nga Maduro që të mbajë zgjedhje të lira presidenciale, të pranuar ndërkombëtarisht. Përfaqësuesit e Maduros dhe udhëheqësit e opozitës firmosin një marrëveshje zgjedhore në Barbados. Disa ditë më vonë, udhëheqësja e opozitës Maria Machado fiton primaret, duke marrë 92% të votave dhe duke u vendosur përballë Maduros.

2024: Gjykata e Lartë e Venezuelës vendos që Maduro nuk është i kualifikuar për të kandiduar në zgjedhje. Qeveria shtyp protestat e opozitës duke arrestuar aktivistë dhe udhëheqës politike, dhe ndalon monitoruesit evropianë në zgjedhje. Administrata Biden akuzon Maduron se ka shkelur premtimet dhe rivendos sanksione.

Qeveria Maduro lejon një zëvendësues të Machados, ish diplomat Edmundo Gonzales, që të regjistrohet si kandidat i opozitës në zgjedhjet e të dielës. / The Washington Post – Bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Demolli: Sadiku e përjetoi rëndë humbjen

PRISHTINË, 30 KORRIK - Boksierja Donjeta Sadiku nuk arriti të futet në zonën e medaljeve në Lojërat Olimpikë pasi u mposht nga boksierja kolumbiane Valdes Pana, kategoria në kategorinë deri në 60 kilogramë. Kjo humbje, sipas sekretarit të Federatës së Boksit të Kosovës, Latif Demolli, ishte e papritur dhe erdhi për shkak të luftës

jokorrekte nga rivalja e Sadikut. Për “KosovaPress”, Demolli zbuloi se pas humbjes Sadiku nuk ishte në gjendje të mirë psikike dhe erdhi në vete vetëm pas disa orësh pushimi. “Donjeta është zhgënjyer shumë nga vetvetja dhe ka rënë në depresion se si ka mundur të humbasë në këtë duel që as në ëndërr nuk e ka parë. Donjeta në

Paris ka ardhur vetëm për medalje dhe ajo ka menduar sidomos deri në gjysmëfinale mos të ketë asnjë problem nga kundërshtarët, por kjo ndodh, ky është sport dhe duhet pranuar humbjen si pjesë e sportit, por Donjeta humbjen e pranoi shumë rëndë dhe ishte në gjendje jo të mirë psikike. Aq përjetoi rëndë sa që iu deshën dy

orë për ta marrë veten dhe për t’u stabilizuar”, ka thënë Demolli. Demolli u shpreh i bindur se Donjeta Sadiku do t’i sjellë Kosovës të tjera medalje evropiane dhe botërore, derisa theksoi se ajo do ta përfaqësojë Kosovën edhe në olimpiadën e radhës që mbahet pas katër viteve. Përveç Sadikut, pa



medalje mbeten edhe xhudistja Nora Gjakova si dhe xhudisti Akil Gjakova, ndërsa me medalje të argjendtë është stolitur Distria Krasniqi.

Infantino pas takimit me presidenten Osmani: Kosova dhe FFK-ja gjithmonë do ta kenë mbështetjen e FIFA-s

“Epoka e re”

PRISHTINË, 30 KORRIK - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, në kuadër të qëndrimit në Paris për Lojërat Olimpikë Verore, është takuar me presidentin e FIFA-s, Gianni Infantino. Takimi u zhvillua në zyrën e FIFA-s në Paris, teksa u diskutua për përmirësimin e infrastrukturës sportive dhe mbështetjen e futbollit në Kosovë nga FIFA. Presidenti Infantino rrjetet sociale e cilësoi si privilegj ta mirëpriste presidenten Osmani dhe e vlerësoi shumë angazhimin e saj për zhvillimin e futbollit në Kosovë. “Ishte privilegj ta mirëprisja presidenten e Republikës së Kosovës, dr. Vjosa Osmani, në

zyrën e FIFA-s në Paris. Më parë pata nderin të takoja dr. Osmani gjatë vizitës sime në vendin e saj të bukur në vitin 2022, dhe kjo ishte një mundësi e shkëlqyer për t’i vazhduar diskutimet tona. Ne folëm për mënyrën se si futbollit mund t’i bashkojë njerëzit dhe shikua planin për ta vazhduar përmirësimin e infrastrukturës sportive në Kosovë, e cila do t’i mbështesë lojtarët e rinj të talentuar të vendit për ta realizuar potencialin e tyre”, ka thënë Infantino, duke vlerësuar lart punën e Federatës së Futbollit të Kosovës lidhur me programin FIFA Forward. “Federata e Futbollit të Kosovës e ka shfrytëzuar shkëlqyeshëm programin FIFA Forward dhe dr. Osmani e kupton qartë rëndësinë e mbështetjes së shtetit në



zhvillimin e futbollit për t’u ofruar më shumë mundësi vajzave dhe djemve për të luajtur këtë sport të mrekullueshëm. I urova dr.

Osmani shumë fat dhe i thashë që shteti i saj dhe FFK-ja gjithmonë mund të llogarisin në mbështetjen e FIFA-s për zhvillimin e futbollit”, ka shkruar Infantino. Presidenti Infantino është një mbështetës i madh i futbollit të Kosovës dhe ka raporte të shkëlqyeshme me presidentin e FFK-së, Agim Ademi. Ai gëzon simpati të madhe për Kosovën, të cilën e ka theksuar shumë herë, edhe për faktin se ajo do të anëtarësohet në FIFA në Kongresin e parë të tij si president i këtij institucioni. Ky fakt e bën lidhjen në mes të Kosovës dhe FIFA-s edhe më të fortë dhe të veçantë, duke nxitur bashkëpunimin dhe përkrahjen e ndërsjellë për zhvillimin e futbollit në vendin tonë.

Distria Krasniqi: Krenare që e sjell në Kosovë këtë arritje të jashtëzakonshme

PRISHTINË, 30 KORRIK - Xhudistja Distria Krasniqi ka folur pasi e mori medaljen e argjendtë në Olimpiadën e Parisit. Krasniqi u shpreh krenare me arritjen e saj dhe me përfaqësimin e Kosovës në këtë edicion, tre vjet pasi rrëmbeu të artën në Tokio. “Ky rrugëtim ka qenë me sakrificë të panumërta, punë dhe përkushtim, por gjithçka ia vlejti në fund. Jam shumë krenare që

përfaqësoj vendin tim dhe të sjell këtë arritje të jashtëzakonshme në Kosovë”, ka shkruar Krasniqi. “Një falënderim i madh për trajnerin tim të mrekullueshëm, ekipin, familjen dhe miqtë për mbështetjen e tyre të palëkundur dhe besimin në mua. Mbështetja juaj ka qenë forca ime shtytëse. Kjo medalje e argjendtë është e veçantë pasi



është medalja ime e dytë Olimpikë, e para në ‘Tokyo 2020’ e fituar në një kategori tjetër”, ka shtuar Krasniqi. “Jam shumë e lumtur që arrita në finalen olimpikë edhe një herë dhe mirënjohëse për mundësinë për të garuar në nivelin më të lartë. Faleminderit të gjithëve që kanë qenë pjesë e këtij udhëtimi të jashtëzakonshëm!”, ka përfunduar Krasniqi.

Kosova në grup me Bosnjë-Hercegovinën dhe Belgjikën

PRISHTINË, 30 KORRIK - Hendbollistët e Përfaqësueses së Kosovës do të garojnë në Grupin 2 të fazës së parë kualifikuese për Kampionatin Botëror të vitit 2025. Shorti i tërhequr të martën në Vjenë ka përcaktuar që Kosova të jetë në të njëjtin grup me Bosnjë-Hercegovinën dhe

Belgjikën. Në short Kosova ishte në vazon e parë falë ngritjes së vazhdueshme të viteve të fundit. Grupi i parë përbëhet nga Greqia, Lituania dhe Britania e Madhe. Në grupin e tretë janë Finlanda, Izraeli dhe Estonia, kurse në grupin e katërt janë Italia, Luksemburgu e Bullgaria.

Ndeshjet e grupit të Kosovës pritet të zhvillohen në Belgjikë prej 25 deri më 27 tetor. Nëse Belgjika nuk e shfrytëzon të drejtën e organizimit të turneut, atëherë ndeshjet zhvillohen në Kosovë. Grupi vlerësohet solid, ndërsa synim i Kombëtares sonë do të jetë vendi i parë dhe avancimi në plejof.



Broja kërkohet nga Evertoni dhe Brentfordi, 'ëndërron' Milanin

LONDËR, 30 KORRIK - Armando Broja ende nuk e ka zgjidhur të ardhmen. Ai për momentin është i grumbulluar në Amerikë me Chelsea, por vijon të jetë me valixhe në duar në pritje të ndonjë oferte interesante nga Anglia, por

edhe jashtë saj. Sipas medieve angleze, Evertoni është rikthyer në pistën e sulmuesit shqiptar, ndonëse nuk dihet nëse është arritur ajo që kërkojnë "Blutë", pra pagesa prej 30 milionë paundësh për kartonin. Klube të tjera të

Premierligës si Brentford apo Southampton janë në garë, ndërsa në Itali mbeten të interesuar "Djajtë" e Milanit. Në fakt, kuqezinjtë padyshim janë dëshira e madhe e Brojës, i cili do të luante në Ligën e Kampionëve vitin e ardhshëm

dhe do ta vishte fanellën e një prej klubeve më prestigjioze në botë, atë të shtatë herë kampionëve të Evropës. Milani, ndërkaq, pëlqen më shumë Tammy Abraham nga Roma, dhe shqiptari është alternativë e dytë.



Sa kushtojnë medaljet e arta?

PARIS, 30 KORRIK - Lojërat Olimpikë janë kulmi i suksesit dhe shpërblimit për çdo atlet, veçanërisht nëse pjesëmarrja kombinohet me një medalje ari. Megjithatë, përtej kënaqësisë morale dhe njohjes, vlera e medaljes së artë është me interes të madh. Medaljet e arta të fituara nga atletët e Lojërave Olimpikë në realitet nuk janë ar i pastër pavarësisht ngjyrës që kanë. Një medalje e artë olimpikë është bërë prej 92.2 % argjendi. Ari që ka është vetëm 6 gramë. Ndryshe nga argjendi dhe bronzi, të cilët janë të dy plotësisht të ngurtë në metalet e tyre përkatëse. Por sa kushton medalja e artë? Kostoja e një medalje ari në Lojërat e fundit Olimpikë në Tokio në vitin 2020 arriti në rreth 640 euro. Argjendi kishte një çmim rreth 350 euro, ndërsa bronzi vetëm 7 euro. Sipas "NBC Sports", ka variacion në çmimin e medaljes së artë, pasi mund të arrijë deri në 775 euro. Medaljet në Lojërat Olimpikë të



Parisit të këtij viti nuk janë vetëm të frymëzuara nga Kulla Eifel, por secila përmban një pjesë autentike të monumentit ikonik të shekullit 19. Çdo olimpist do të marrë një copë hekuri autentik nga Kulla Eifel e vendosur në zemër të medaljes së tyre. Secila nga 5 084 medaljet që do të jepen në ngjarjen kryesore botërore mban një gjashtëkëndësh të hekurt nga Kulla Eifel, ndërsa

logoja "Paris 2024" dominon. Në anën e djathtë janë gdhendur figurat e Athinës, Hyjneshës së Fitores, Stadiumi Panathenaik dhe Akropoli, siç kërkohet nga Komiteti Olimpik Ndërkombëtar (IOC), por "Paris 2024" mori leje të veçantë për t'u riprodhuar në medalje dhe Kulla Eifel. Në të njëjtën kohë, disiplina për të cilën jepet medalja shkruhet në "buzë" të medaljes.

Usyk provokon Fury: Mos ki frikë, unë nuk do të lë vetëm

LONDËR, 30 KORRIK - Boksieri ukrainas Oleksandr Usyk paralajmëron britanikun Tyson Fury që të mos ketë frikë përpara revanshit që do të zhvillojnë këtë dhjetor. Një deklaratë që vjen pas asaj të Furyt, që ka thënë se ai e humbi sfidën e parë mes tyre sepse e kishte "shumë të lehtë". Usyk mundi Furyt në maj përmes një vendimi të ndarë për t'u bërë kampioni i padiskutueshëm i botës në peshën e rëndë. Ukrainasi foli për sfidën e planifikuar më 21 dhjetor në Arabinë Saudite, në një intervistë ekskluzive me "Sky News" në Ambasadën e Ukrainës në Londër. "Oh zot, nuk ka mundësi që Fury bën ato deklaratë. Gjithsesi, nuk ka problem. Sfidat e ardhshme do të jetë serioze e lehtë për të. Për mua, revanshi ndaj tij do të jetë i vështirë sepse Tyson Fury është një burrë i madh, një boksier i mirë, me një përgatitje të mirë boks", u shpreh Usyk. "Por, nëse Tysoni thotë se për të do të jetë e lehtë, për mua nuk ka problem. Unë shoh në sytë e Tyson Furyt që nuk është e lehtë.



Do të jetë e vështirë, shumë, shumë e vështirë. Tyson, mos ki frikë, unë nuk do të lë vetëm", ka deklaruar Usyk, duke i dërguar edhe një puthje britanikut. "Tyson ka një familje të madhe, unë kam një familje të madhe. Gjithçka është në rregull. Unë nuk mendoj për arbitrin pasi ka përfunduar sfida. Ne fitojmë dhe falë Zotit gjithçka është mirë, gjithçka është në rregull. Unë mendoj se arbitri është i mirë. Thjesht njerëzit flasin

bla bla bla", u shpreh Usyk. 37-vjeçari, i cili ka një rekord 22-0, pranoi se Fury i kishte shkaktuar dëme në pjesë të ndryshme të trupit, ndërsa e krahasoi britanikun me një Yeti. "Po, kam pak probleme me grushtin, shpinën, gjithë trupin sepse ishte një luftë e vështirë, 47 minuta. E shihni Tyson Fury, ai është si një Yeti. Është i vështirë. Fytyra ime është e mirë, e bukur", ka pohuar Usyk.

SHKURT

Këtë javë vendoset e ardhmja e Gjimshitit

Berat Gjimshiti mund ta mbyllë aventurën në Itali me Atalantën dhe të nisë një të re në Lindjen e Mesme, më saktësisht në Katar. Kapiteni i Kombëtares shqiptare, i cili së fundi u gradua kapiten i skuadrës bergamaske, është në bisedime të avancuara me skuadrën e Al Rayyan, me të ardhmen e mbrojtësit që do të vendoset këtë javë. Duket se dhe Atalanta është e gatshme ta shesë Gjimshitin, nëse ky i fundit pranon të largohet, por jo për një shumë më të vogël se 15 milionë euro. Në fakt, klubi zikaltër është duke pritur çfarë do të ndodhë me të ardhmen e 31-vjeçarit shqiptar, në mënyrë që të avancojë më tej për t'i siguruar shërbimet e Kevin Danso nga Lens.

Grisi Koxhaku eliminohet nga gara e notit

Ka përfunduar aventurën e tij në Lojërat Olimpikë "Paris 2024" edhe notari shqiptar Grisi Koxhaku. Ai mori pjesë sot në garën e 100 metrave stil i lirë. Koxhaku garoi në baterinë e tretë, ku u klasifikua në vendin e pestë, me kohën 52"32. Një paraqitje relativisht pozitive për notarin e ri shqiptar, por që nuk arrin të kualifikohet më tej. Gjithsej ishin 10 bateri në këtë disiplinë, ku në gjysmëfinale shkuan 16 kohët më të mira, ndërkohë që koha e dhënë nga Koxhaku ishte larg më të mirëve. Në total ai u klasifikua në vendin e 62-të mes 79 garuesve. Si Koxhaku ashtu dhe notarja Kaltra Meça që garoi dy ditë më parë fituan një përvojë të rëndësishme për të ardhmen e tyre. Deri më tani për ngjarat kuqezi kanë garuar dy notarët dhe qitësja Manjola Konini, në 10 metra pistoletë ajri. Kjo e fundit do të garojë edhe më 2 gusht në 25 metra pistoletë precesion. "Grisi Koxhaku e mbylli garimin e tij në vendin e 5-të në baterinë 3, me kohën 52.32. Një garë modeste për sportistin debutues të Team Albania", njofton Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar.

Sainz do të garojë me makinën Williams sezonin e ardhshëm

Piloti spanjoll Carlos Sainz do të garojë me makinën Williams sezonin e ardhshëm të Formula 1. Siç dihet, piloti aktual i Ferrarit do t'ia lë vendin Lewis Hamiltonit sezonin e ardhshëm dhe vetë ka vendosur të garojë për një nga makinat veterane në Formula 1. Sainz, tri fitore dhe 32 podiume në karrierën e tij, ka firmosur një kontratë dyvjeçare me Williamsin, me opsionin për ta shtyrë atë edhe më tej. Këtë vit ai fitoi në Australi vetëm dy javë pasi kreu një operacion të apandesisit, ndërkohë që është ngjitur në katër podiume. Shoku i tij i ardhshëm i skuadrës do të jetë Alex Albon dhe do të vijojë të mbajë nr. 55 në njëvendëshen e tij. Kishte shumë oferta për spanjollin, që duket se vendosi të garojë me Williamsin. "Jam i lumtur që do të jem pjesë e kësaj skuadre vitin tjetër", ka deklaruar Sainz. "Desha pak kohë për të vendosur dhe jam krenar që do të jem pjesë e një skuadre historike dhe me shumë suksese. Objektivi është ai i rikthimit të Williamsit në vendin që i takon. Një sfidë që e pres me kënaqësi dhe entuziazëm", u shpreh Carlos Sainz.

PSG-ja ia ofron Unitedit tre lojtarë për Sanchon

Paris Saint-Germain thuhet se është gati t'i ofrojë Manchester Unitedit tre lojtarë në këmbim të Jadon Sanchos. Sulmuesi anësor është mirëpritur seriozisht

në grup nga menaxheri Erik ten Hag pas dështimit sezonin e kaluar. Megjithatë, sipas "Sportzone", PSG-ja ka qenë në kontakt me Sanchon për një

lëvizje në Paris, me kushtet personale tashmë të arritura mes palëve. Tani PSG-ja do të kërkojë bisedime me Unitedin për një tarifë për reprezentuesin

anglez. Tre lojtarë të PSG-së thuhet se do të jenë në tavolinë për konsideratë nga Unitedi me emra si Manuel Ugarte, Nordi Mukiele dhe Milan Skriniar.

Unitedi tashmë është në bisedime me parisienët për mesfushorin e Uruguait, Ugarte, por sigurisht që ky i fundit vlen më shumë.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “F&F Business Services” L.L.C. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrB UNIK: 812007418 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “F&F Business Services” D.O.O. od Prishtina, donelo odluku o prestani rada sa nrB. 812007418 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “F&F Business Services” L.L.C. with headquarters Prishtina, has come to the decision to quit its business: 812007418 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Enis Lahu shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme “Arkitekt Sinani”.

- Vilson Kurti shpall të pavlefshme dëftesat dhe certifikatën e testit të maturës dhe diplomën e shkollës së mesme “Arkitekt Sinani”.

- Nevzat Berisha shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme profesionale “Bahri Haxha”-ish shkolla e mesme “Muharrem Bekteshi”.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanë me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

Lumë's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lumë's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992







ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

